



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni Pranveror
Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja Nr. 36
Prishtinë, më 5.07.2010, ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Sanije Aliaj, Enis Kervan, Numan Balić, Mursel Haljilji, Zylfi Merxha, Sadik Idriz, Müfera Şinik, Hafize Hajdini, Xhevdet Neziraj dhe Rexhep Hoti .

Munguan: Petar Miletić, Dragiša Mirić dhe Hetem Arifi.

Në mbledhje prezantuan: përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit.

Nga Stafi Mbështetës: Natasa Prica-Tisma, dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Sanije Aliaj, Zëvendëskryetare parë e Komisionit

Në këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Shqyrtimi i Projektligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, me amendamente;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Grevat me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, me amendamente;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për Avokatin e Popullit me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, me amendamente;
5. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës nr. 03/L-207 me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Punë të Jashtme, me amendamente;
6. Shqyrtimi i Projektligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, me amendamente;
7. Të ndryshme

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesja - paraqiti shqetësimin e marrjes së informatës për tentim atentati ndaj kryetarit të Komisionit, Petar Miletic. Komisioni konsideron se ky është një akt terrorist ndaj Institucioneve të Republikës së Kosovës dhe popullit në përgjithësi.

Anëtarët e Komisionit, shprehin shqetësimin e njëjtë edhe ndaj aktit terrorist që ka ndodhur para dy ditësh në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë, ku humbi jetën një mjekë boshnjak dhe 11 të tjerë të plagosur.

Me këtë rast, Komisioni kërkoi nga Qeveria e Republikës së Kosovës, nga MPB si dhe Policia e EULEX-it që të merren të gjitha masat për ndriçimin e rasteve dhe kryesit e veprave të dalin para organeve të drejtësisë.

Anëtarët e Komisionit ndajnë dhembjen me z. Petar Miletic dhe me familjarë të tjerë, njëherit iu dëshirojnë shërim sa më të shpejtë.

Kryesuesja, konstatoi që Komisioni të miratoi rendin e ditës, si është propozuar.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, me amendamente;

Pasi që nuk kishte vërejtje, **kryesuesja** konstatoi se Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës dhe amendamentet e komisionit funksional, ka konstatuar se projektligji dhe amendamentet nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Grevat me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, me amendamente;

Kryesuesja, konstatoi se Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për Grevat dhe amendamentet e komisionit funksional, ka konstatuar se projektligji dhe amendamentet nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për Avokatin e Popullit me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, me amendamente;

Kryesuesja, konstatoi se Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim nxori këtë

R E K O M A N D I M

I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për Avokatin e popullit dhe amendamentet e komisionit funksional, ka konstatuar se projektligji dhe amendamentet nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

5. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës nr. 03/L-207 me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Punë të Jashtme, me amendamente;

Kryesuesja, konstatoi se Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës nr. 03/L-207 dhe amendamentet e komisionit funksional, ka konstatuar se projektligji dhe amendamentet nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

6. Shqyrtimi i Projektligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, me amendamente;

Kryesuesja konstatoi se Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe amendamentet e komisionit funksional, ka konstatuar se projektligji dhe amendamentet nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

7. Të ndryshme

Kryesuesja - njoftoi Komisionin lidhur me kërkesën e Hafize Hajdinit, që të shqyrtojmë çështjen e projektit për ndërtim të disa shtëpive në Ferizaj. Pas konsultimeve lidhur me kërkesën, Komisioni nxori këtë:

Përfundim

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, në mbledhjen e mbajtur me 5.07.2010, merr qëndrim që në mbledhje të radhës të ftojë Ministrin për Komunitete dhe Kthim, me qëllim që të ofrojë sqarim lidhur me gjendjen e projektit të Dubravës.

Mbledhja përfundoi në orën 13:45

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Zëvendëskryetarja e parë Komisionit

Sanije Aliaj